REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE,PROKURIMEVE DHE KONTRATAVE
SEKTORI JURIDIK DHE I PROKURIMEVE

PROJEKT-VENDIM

Nr. 39, Date 22/04/2026

"PER MIRATIMIN E BASHKËORTAKËRISË NËPËRMJET DHURIMIT TË NJË PJESE TË KUOTËS NGA SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR DRITSOL SH.P.K "

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8417,datë 22.11.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, nenit 113 pika 1 shkronja b), Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenit 68,70,71,-104 të Ligjit Nr. 901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"i ndryshuar, nenit 8,9,54 pika 1 germa d) të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligji 9723 datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar,

PROPOZOJ:

1. Miratimin e bashkëortakërisë për zotërimin e kuotës në vlerën 26 % të kapitalit themeltar nëpërmjet dhurimit nga Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar DRITSOL SHPK me Nipt M52006023U me objekt "Projektimi, ndërtimi, zhvillimi, financimi, administrimi, operimi, mirëmbajtja dhe menaxhimi i centraleve për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, kryesisht nga energjia diellore (fotovoltaike), përfshirë prodhimin, shpërndarjen dhe shitjen e energjisë elektrike, si dhe çdo aktivitet tjetër ndihmës apo plotësues lidhur me këtë qëllim. Shoqëria gjithashtu mund të marrë pjesë si ortak ose aksionar në shoqëri të tjera që operojnë në të njëjtën fushë, në vend ose jashtë vendit, si dhe të zotërojë, administrojë dhe zhvillojë projekte energjetike nëpërmjet shoqërive të posaçme. Çdo veprimtari tjetër e lejuar me ligj"
2. Bashkia Devoll pas pranimit të kuotës do të bëhet zotëruese e 26% të kapitalit të shoqërisë me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që përcakton ligji dhe statuti i shoqërisë.
3. Kjo Shoqëeri do të funksionojë në përputhje me Ligjin Nr. 901/2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" i ndryshuar.
4. Çdo pasuri e luajtshme dhe/ose e paluajthsme në pronësi apo administrim të Bashkisë Devoll që do i vihet Shoqërisë DRITSOL SHPK në të cilën Bashkia Devoll do të jetë bashkëpronare, për përdorim, administrim dhe/ose zhvillim, në të gjitha rastet do të miratohet paraprakisht nga Këshilli i Bashkisë Devoll.

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com